

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje të trupit gjykues prej gjyqtarit Skender Çoçaj, si kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve Kymete Kicaj e Xhemil Elshani, si anëtarë, me procesmbajtësen Birsën Kume sekretare juridike e kesaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit I. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Prizren, PP.nr.50/2009 të datës 23.04.2009, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.H. S. me datë 22.05.2017, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I. M., nga i ati E. dhe e ëma Xh., e gjinisë G., i lindur më datë , në fshatin, ku edhe tani jeton, në Rrugën , punëtor i ndërtimtarisë, i martuar babë i dy fëmijë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike me shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim prej datës 23.03.2016.

II. H. M., nga i ati A. dhe e ëma F. e gjinisë M., i lindur me datë në fshatin Komuna e Gjakovës, me profesion bukëpjekës me punë të përkohshme në , Republika e Malit të Zi, i martuar babë i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme të nxënësve në ekonomik, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I.

Ndaj të akuzuarit H. i M. në pajtim me nenin 363 paragrafi 1 pika 1.1

REFUZOHET AKUZA

Se me datë 06.03.2009 rreth orës 21,06 minuta, në Prizren në RR. nr. kishte shkuar në shtëpinë e të akuzuarit I. M. për të kërkuar borxhin prej vëllait të tij kur kishte dalë I. ish in fjalosur verbalisht pastaj edhe e kishte sulmuar me grushta por ka ndërhy familjarët dhe është larguar nga dera e I. për të shkuar në drejtim të automjetit, në ndërkohë I. kishte marr armën e zjarrit dhe kishte plagosur të birin e tij L. M., atëherë H. M. vërsulet në drejtim të pandehurit I. M. nxjerr thikën dhe lëndon rëndë shëndetin e njeriut duke sulmuar në pjesë të ndryshme të trupit me ç' rast i shkakton lëndime të lehta trupore në syrin e majtë si shtypje e shoqëruar me skuqje, në gjoks, në shpinën e dorës së majtë dhe krih që klasifikohet si gërvishetje dhe në dorën e majtë si plate shqyese pëlçitëse, me çka do të kryente veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pik 4 të KPK.

Për shkak të heqjes dorë të Prokurorit publik nga akuza.

II.

ËSHTË FAJTOR

I akuzuari I: M:

Se me datë 06.03.2009 rreth orës 21,06 minuta në Prizren në Rr. , tenton ta privojë nga jeta të dëmtuarin L. . . . M: . . . nga fshati Komuna e Gjakovës, në atë mënyrë që pasi në oborrin e tij ka patur një përleshje me të akuzuarin H. . . . M: . . . i cili së bashku me të dëmtuarin L. . . . M: . . . dhe dëshmitarin Gju . . . Gju . . . kishin shkuar në shtëpinë e tij për të kërkuar borxhin prej R. . . . ; vëlla i të akuzuarit I: . . . , kishin trokitur në derë dhe pas konfliktit verbal kacafytjes me H. . . . M: . . . , me ç' rast e nxjerr revolen, kur edhe largohen he . . . M: . . . e L. . . . M: . . . , del te dyert e oborrit dhe u vihet pas dhe me një distancë prej 15-20 m, hap zjarre me revolen e tipit "Skorpion" e prodhimit çekoslovak duke shkrepë dy herë me ç' rast me një plum e qëllon në të tretën e sipërme të faqes së brendshme të kofshës së djathtë që klasifikohet në plagë shkuese duke përshkruar lëkurën indet e buta dhe duke përfunduar në brendinë e kofshës me ç' rast L. . . . M: . . . i shkakton lëndime të lehta trupore të përshkruara nga eksperti i mjekësisë ligjore Cr.C. . . . M: . . . me datë 19.03.2009.

-Me këtë ka kryer veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK.

Andaj, gjykata në bazë të neneve: 2 par. 1, 6, 11, 34, 36, 38, 64, 73, të KPK-së dhe neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së të akuzuarin e:

GJYKON

-Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj në të cilën do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.06.03.2009 deri më datën 04.06.2009.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguan shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 100 €, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka ngritur aktakuzë PP.nr.50/2009 të datës 23.04.2009 kundër të pandehurit I: . . . M: . . . e H. . . . M: . . . i, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK. Në fjalën përfundimtare Prokurori i shtetit ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës ndaj I: . . . M: . . . për veprën vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK, pasi që gjatë rigjykimit që është mbajtur si dhe duke u përmbajtur udhëzimeve të Gjykatës Supreme, me provat të cilët janë administruar, deklaratat e të dëmtuarit H. . . . M: . . . , L. . . . M: . . . , Gj. . . . Gju . . . si dhe dëshmitarëve tjerë, nga mendimi i ekspertit të balistikës H. . . . K: . . . i, si dhe i atij mjekoligjor Dr.C. . . . M: . . . , përkitazi me natyrën e lëndimeve që ka pësuar nga arma e zjarrit L. . . . M: . . . , pa mëdyshje nga këto prova është vërtetuar edhe gjendja faktike e përshkruare si në dispozitivin e akuzës së datës 06.03.2009.

Andaj, ka propozuar që i akuzuari për këtë veprë penale të shpallet fajtorë dhe ë dënohet sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, gjykata të merr parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. H. ... S. ... në fjalën përfundimtare ka deklaruar se aktakuza e prokurorit të shtetit në pretendimin se i akuzuari me veprimet e ndërmarra ka kryer veprën penale në shkelje të nenit 146 të KPK lidhur me nenin 20 të KPK faktikisht dhe juridikisht nuk qëndrojnë duke shtuar se i akuzuari me veprimet e ndërmarra ka vepruar në mbrojtje të nevojshme në kuptim të nenin 8 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, me deklarimin e tij i akuzuari i përcaktoi konkretisht veprimet e tija, ne vazhdim në tërësi sikurse ne fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim të datës 22.02.2012, ku ka deklaruar se nga provat e administruara në shqyrtimin kryesor akuza e prokurorisë nuk mund të qëndroj sepse nuk kanë mundur të provohen veprimet e inkriminuara të cilat i ngarkohen të akuzuarit, duke shtuar se veprimet e ndërmarra nga i akuzuari I. ... M. ... konsistojnë në veprime të ndërmarra në mbrojtjen e nevojshme dhe këto veprime të akuzuarit janë ndërmarrë pasi që i akuzuari H. ... M. ... dhe L. ... M. ... kanë hyrë në oborr të shtëpisë së të akuzuarit I. ... M. ... me ç' rast H. ... M. ... e sulmon furishëm të njëjtin duke e shtrënguar për fyti për ta mbytur, por ndërhyjnë bashkëshortja e të akuzuarit I. ... M. ... si dhe kunata e tij për ta larguar të akuzuarin H. ... M. ... dhe sulmi i L. ... M. ... dhe mezi disi pasi që i akuzuari I. ... M. ... e nxjerr revolen sulmuesit e lirojnë të akuzuarin M. ... dhe fillojnë paksa të largohen por me synim të vazhdimit të sulmit ndaj I. ... M. ... Kështu sulmuesit nga vetura e tyre të cilën e kishin parkuar aty afër marrin thikë dhe kthehen sërish për ta sulmuar të akuzuarin I. ... M. ... I akuzuari I. ... M. ... nga dera e oborrit të tij duke vështuar se a janë larguar sulmuesit vëren sulmin e serishëm të të akuzuarit H. ... M. ... dhe të L. ... M. ... duke qenë në këtë situatë i akuzuari I. ... M. ... për ta zbrapsur sulmin e aty për atyshëm dhe të rrezikshëm për jetën e tij, me armën që e posedonte shkrep një rafal në afërsi prej 2-4m në drejtim të L. ... M. ... për ta frikësuar për ta dëbuar sulmin dhe atë me ç' rast e godet të njëjtin duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore jo të rrezikshme për jetën, mirëpo edhe përkundër kësaj sulmi megjithatë nuk ishte ndërprerë dhe të njëjtit arrin që sulmin ndaj të akuzuarit I. ... M. ... ta përfundojnë me sulmin e pandërprerë të tyre ndaj tij. I akuzuari I. ... M. ... ka qenë i detyruar të shkrepë me revole në drejtim të tyre pasi që të njëjtit e kanë vazhduar sulmin e filluar që më parë ku i dëmtuari L. ... M. ... me thikë në dorë dhe i akuzuari H. ... M. ... janë vërsulur në sulm fizik ndaj të akuzuarit I. ... M. ... cili ka tërhequr vërejtjen që të mos e sulmojnë duke ia drejtuar revolen në drejtim të tyre për të kërkuar zbrapsjen e sulmit të tyre por të njëjtit nuk janë zbrapsur duke e vazhduara sulmin ndaj I. ... M. ... i cili së pari shkrepë me revole anash për ti frikësuar dhe në pjesën e poshtme të trupit të dëmtuarit L. ... M. ... si shenjë e tërheqjes së vërejtjes për zbrapsje me ç' rast të njëjtin e lëndon lehtë në trup duke e goditur me një predhë në këmbë duke seleksionuar goditjen për të mos vrarë por për të frikësuar e me qëllim të dëbimit të sulmit të sulmuesve të akuzuarit H. ... M. ... dhe të dëmtuarit L. ... M. ... , në këtë gjendje të sulmit i akuzuari I. ... M. ... ka qenë i detyruar të shkrepë me revole të cilën e kishte në dorë. Largësia e sulmuesit e skjaron gjendjen se i akuzuari I. ... M. ... nuk ka pas dashje për të vrarë të dëmtuarin L. ... M. ... sepse një gjë të tillë mund ta bënte, nga se largësia ka qenë shumë e afërt dhe arma të cilën e mbante i akuzuari ka pas mjaftë municion, një gjë të tillë e vërteton edhe tërheqja e vërejtjes ndaj sulmuesve dhe shkrepja e revoles në pjesën e poshtme të trupit të të dëmtuarit, pra me qëllim të frikësojë e jo për të vrarë. Nuk qëndron gjendja faktike se i akuzuari I. ... M. ... u ka vu pas të akuzuarit H. ... M. ... dhe të dëmtuarit L. ... M. ... nga se i njëjti i lodhur nga sulmet e këtyre dyve del në dorë për të vështuar veprimet e mëtejme të tyre kur edhe e vrenë L. ... M. ... me thikë në dorë i cili i vërsulet atij, e gjithashtu po të vepronte i akuzuari I. ... M. ... ashtu siç pretendon

akuza, atëherë lëndimet e të dëmtuarit L. M. i do të ishin në pjesën e prapme të trupit të tij e jo në pjesën e parë të ballit të tij. Po ashtu gjendja faktike vërteton se i akuzuari L. M. ka mundur ti vërras sulmuesit sepse ka mundur të gjuaj në pjesët vitale të trupit të të dëmtuarit L. M. por ai shkrep në drejtim të pjesës jo vitale të trupit të të dëmtuarit dhe më tej nuk vazhdon. Pra në rastin konkret ka munguar dashja e të akuzuarit I. M. për të vrarë, kjo për faktin se i njëjti ka shkrepur vetëm një rafal dhe është ndalur për të pritur që sulmi i filluar ndaj tij të ndërpritet edhe pastaj fare nuk ndërmerret ndonjë veprim tjetër me armën të cilën e mbante si mjet mbrojtës. Tezën e mbrojtjes, se i akuzuari I. M. ka vepruar në mbrojtje të nevojshme e vërtetojnë edhe provat materiale të administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, dhe atë mënyra e veprimit dhe përdorimit të mjetit nga i akuzuari I. M. ka qenë e domosdoshme. Për t'ju kundërvu sulmit e duke shkaktuar pasoja pafajësinë e tij e që tregon dashjen e të akuzuarit I. M. për ta zmbarsur sulmin ndaj tij e jo për ta vrarë të dëmtuarin L. M. si dhe të akuzuarin H. M. Ka shtuar se i akuzuari I. M. ka vepruar në mbrojtje të nevojshme e cila ka qenë në proporcion të plotë në shkallën e rrezikut të cilin e ka paraqit sulmi i atëçastshëm nga sulmuesit L. M. dhe H. M. të cilët njëri e kishte në dorë thikën duke e rrezikuar jetën e të akuzuarit e që përdorimi i revoles në rastin konkret nga i akuzuari ka qenë në proporcion me kërcënimin e bërë. Në fund ka deklaruar se nëse gjykata nuk e aprovon propozimin e mbrojtjes se janë plotësuar kushtet ligjore se i akuzuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme ka theksuar se i akuzuari prapë se prapë ka vepruar në tejkalimin e kufijve të mbrojtjes së nevojshme për shkak të tronditjes së fortë dhe frikës së shkaktuar nga sulmi i sulmuesve e për të cilën vlejné të njëjtat arsyetime sikurse edhe për tezën e mbrojtjes së nevojshme.

Në dëshminë e tij të dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar i dëmtuari L. M. të cilën gjykata e ka lexuar gjatë shqyrtimit kryesorë pasi që i njëjti ka ndërruar, jetë i dëmtuari ka deklaruar se kanë shkuar te dera e Ismetit sipas marrëveshjes që e kishin bërë më herët, Ismeti e ka hapur derën dhe e ka tërhequr babain e tij me forcë në oborr, ndërsa ai kishte mbetur jashtë derës, për çka i kishte mëshuar derës me këmbë dhe është futur mbrenda, ku edhe e kishte pa Ismetin me armë në dorë, gratë që ishin në oborr e kishin kapur I. M. dhe ju kishin thënë "largohuni se ne e mbajmë", kështu që i dëmtuari dhe babai i tij kishin dal jashtë, në ato momenti ka dëgjuar gruajën e L. M. duke thënë "o ikni se na shpëtoi", pasi që këta kishin dal jashtë kishin shkuar deri te automjeti i tyre i cili ishte i parkuar diku 20-30 metra larg dyerve të Ismetit, Ismeti ka gjuajtur tri herë me armë me ç'rast ai kishte marr dy lëndime njëra shpuese e tjetra rëshqitëse, familjarët e L. M. kanë vrapuar pas tij, mirëpo nuk kanë qenë në gjendje me e ndal. Në këto momente i dëmtuari dhe babai i tij ishin afër veturës së tyre gati për tu nisur me u largua. Në vazhdim i dëmtuari kishte deklaruar se me R. M. janë marr vesh me e kompenzua borxhin me arrën në Lipjan por kjo kontratë nuk është realizuar, kanë provuar që të kontaktojnë kohë pas kohe, por nuk kanë mundur, prandaj edhe janë detyruar që ditën kritike të shkojnë në shtëpinë e tij të merren vesh, pasi që kontrata nuk u realizua, mirëpo meqenëse R. M. nuk ishte në shtëpi babai i të dëmtuarit ishte marr vesh me telefon me të familjes së I. M. që të takohen në mbrëmje rreth orës 9:00 tek shtëpia e tij.

Gjykata i ka nxjerr të gjitha provat e nevojshme dhe pas administrimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave në tërësi ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Në tërësi është vërtetuar se i akuzuari Ismet Muji me datë 06.03.2009 rreth orës 21,06 minuta në Prizren në Rr. ... nr. ... tenton ta privojë nga jeta të dëmtuarin L. M. nga fshati ... Komuna e Gjakovës, në atë mënyrë që pasi në oborin e tij ka pasur një përleshje me të akuzuarin H. M. i cili së bashku me të dëmtuarin L. M. dhe dëshmitarin G. G. kishin shkuar në shtëpinë e tij për të kërkuar borxhin prej R. M. vëlla i

*të akuzuarit I: kishin trokitur në derë dhe pas konfliktit verbal kacafytjes me H. M. me ç' rast e nxjerr revolen, kur edhe largohen H. M. e L. M., del te dyert e oborrit dhe u vihët pas dhe me një distancë prej 15-20 m, hap zjarre me revolen e tipit "Skorpion" e prodhimit çekoslovak duke shkrepë dy herë me ç' rast me një plumb e qëllon në të tretën e sipërme të faqes së brendshme të kofshës së djathtë që klasifikohet në plagë shkuese duke përshkruar lëkurën indet e buta dhe duke përfunduar në brendinë e kofshës me ç' rast L. M. i shkaktonte lëndime të lehta trupore të përshkruara nga eksperti imjekësisë ligjore Cr. M. me datë 19.03.2009.

I akuzuari L. M. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit kryesorë është mbrojtur se rasti ka ndodhur në oborrin e shtëpisë së tij, i njëjti ka qenë para derës së oborrit në rrugë dhe armën e ka pasur me veti me të cilën ka shkrepur në vetëmbrojtje e jo në drejtim të H. M. dhe L. M., ka shtuar se këta kanë qenë shumë afër tij ndërsa i akuzuari kishte dalë jashtë derës për të shikuar se a janë larguar apo jo kur të njëjtit e kanë sulmuar me thika ma ç' rast H. M. e ka goditur me thikë në zemër dhe gjatë përlëshjes ka marrë lëndime në dorën e majtë sepse e ka kapur thikën duke u mbrojtur, lëndime në sy sepse H. M. ia kishte shti gishtin në sy si dhe lëndime afër zemrës ku ishte gërvishur edhe këmishën e kishte të shkyer me thikë, deri sa ishte në oborr ka qenë i detyruar që të shtënë me armë sepse ka qenë i sulmuar me thikë nga L. M. por i njëjti është ndalë por babai i tij H. M. e ka sulmuar me thikë dhe i ka ra në zemër dhe të gjitha lëndimet ia kishte shkaktuar H. M., me armë ka gjuajtur në drejtim të tokës që ta ndalte L. M. dhe vetëm njëherë ka shkrepur me rrafall, këta janë larguar vetëm kur e ka nxjerr armën dhe i kishin ndarë "granimi" ndërsa në këtë moment i akuzuari ishte para derës së oborrit të tij jashtë derës së oborrit diku gjysmë metër deri në një metër, . Këtë armë e kishte mbajtur me vete dy vite, sepse vëllau i tij R. M. kishte probleme me faidexhitë dhe vazhdimisht kishin kërcënime në vazhdim është mbrojtur se vëllai i tij R. M., në një rast është paraqitur prej Prishtine dhe ka shkuar që ta marrë. Takimi ka qenë te restoranti te kthesa Lipjanit "Motrat Binjake". Aty ka pa R. M. i cili ishte në shoqëri me L. M. dhe Gj. M. të cilin ma vonë e kam njoftë se kush është. Aty është zhvillu bisedë se R. M. i kishte borxh një malazezi për çka kishte garantuar H. M. Prandaj R. M. që t'ia kompensonte borxhin me një person të Lipjanit kanë lidhë marrëveshje që një pasuri prej 40 arësh të jetë si kompensim për H. M. Unë në ndaje kam lutë R. M. eja në shtëpi por L. M. dhe Gj. M. kanë thënë se pa u krye çështja e borxhit nuk mundet me ardhur në shtëpi. Me gjithë atë unë kam fol me R. M. veçmas dhe nuk fitova përshtypjen e ai është i ndalur me dhunë. R. M. gjatë tërë kësaj kohe nuk ka ardhur në shtëpi. Në një rast kam paraqitur në polici dhe R. M. kam gjetur në një lokal afër fshatit Gelancë, policia e ka marrë në pyetje R. M. dhe H. M., por R. M. nuk është kthyer në shtëpi. Një ditë pra me 06.03.2009 unë kam qenë në punë, bashkëshortja ime ka fol në telefon dhe në lidhje më ka dhënë H. M. i cili më tha duhet të bisedojmë rreth borxhit, dhe mundësisht merre edhe mikun tënd që të definojmë këtë çështje. Unë i kam thënë nuk ka nevojë për mikun por eja në ora 9 të natës. Në mbrëmje kanë ardhur 3 persona dhe H. M. më ka sulmuar më ka kapur për fyti unë e kam nxjerrë revolen me ç' rast ka dalë prej oborrit së bashku me djalin e tij L. M. Unë kam shkuar te dyert e oborrit kam vërejt se përsëri do të më sulmojë, prandaj kam shkrepë me revole në drejtim të sulmuesve. Vetëm pas kësaj H. M. ka hy në oborr me thikë dhe më ka lënduar. Në fund të mbrojtjes së tij i akuzuari ka deklaruar se krejt kjo ngjarje ka ndodhur në shtëpinë e tije, me këta persona s'kishte pasur kontakt kurrë njëherë dhe kur kishin shkuar në shtëpinë e tij gjoja se kanë dashtë të bisedojnë me të akuzuarin, por kur ja ka qelë derën e kanë sulmuar menjëherë.

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit gjykata vlerësoi se mbrojtja e të akuzuarit është e drejtuar kah evitimi i përgjegjësisë penale, është kontradiktore dhe se nuk ka mbështetje në provat e administruara, nuk është e bindëse dhe është në kundërshtim me të gjitha

dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar si dhe provat materiale të administruara në shqyrtimin kryesorë. Në të vërtetë i akuzuari I. nuk e mohon se ditën kritike në shtëpinë e tij kishin shkuar i akuzuari H. i dëmtuari L. me të cilët edhe kishte pasur një konflikt, gjithashtu i njëjti nuk e mohon se me vete kishte revole dhe ka gjuajtur në drejtim të tyre me që rast edhe e ka goditur të dëmtuarin L. M., por i njëjti është mbrojtur se ka vepruar në vetëmbrojtje pasi që është sulmuar nga i akuzuari H. M. dhe i dëmtuari L. M., e që gjatë shqyrtimit kryesorë nuk është vërtetuar një pretendim i tillë i të akuzuarit, ngase me provat e administruar është vërtetuar se në momentin kur i akuzuari I. ka gjuajtur me armë në drejtim të dëmtuarit L. nuk ka qenë fare i sulmuar nga askush aq më pak nga i dëmtuari L. i cili fare nuk e ka sulmuar të njëjtin.

Gjendjen e këtillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarit-të dëmtuarit L. M., dëshmitarve H. M., Dr. M., Gj. Gj., She. R., T. S., L. M., Hal. Gava, Dr. C. Morina, si dhe provat materiale dhe atë : ekspertiza mjekoligjore e Dr. C. Morina lidhur me lëndimet e të dëmtuarit L. M., dëshmia e ekspertit H. Kelu, raportit mbi rikonstruimin e vendit të ngjarjes të kryer nga eksperti H. Kelu, raporti i rikonstruimit të vendit të ngjarjes të kryer nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren nr. RVK - i datës 10.01.2012, skica e vendit të ngjarjes, foto dokumentacioni, vendimi mbi trashëgiminë TR.nr. të datës 10.03.2009, procesverbali i gjykatës mbi rikonstruimin e vendit të ngjarjes të datës 10.01.2012, kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë datë 20.02.2009 e lidhur në mes të Sh. R. dhe L. M.

Dëshmitari Gj. Gj. ka deklaruar se R. M. kishte marr borxh prej një Malazezi e me që borxhin nuk ka mundur që ta kthejë ai edhe ishte kërcënuar me kidnapim, por H. kishte intervenuar përmes telefonit duke i garantuar Malazezit se do ti kthehet borxhi, prandaj edhe R. është liruar. Ditën kritike kur kanë shkuar në mbrëmje te shtëpia e R. dëshmitari ishte ndalur tek automjeti i cili ishte 30 metra larg prej dyerve të oborrit të I. me tu përshëndetur vetëm me H. menjëherë e ka tërhequr brenda në oborr. Ka shtuar se ai nuk është afruar por ka dëgjuar dhe e ka pa se I. pasi që H. dhe L. gati sa janë afruar te automjeti dhe ishin duke u futur në automjet ka dëgjuar krisma armësh dhe e kishte parë I. që gjuajtjet i kishte në drejtimin e tyre e në një moment e ka pa se është goditur L. Në këtë situatë H. përsëri është kthyer dhe ka hyrë në oborrin e I. se si është zhvilluar përleshja nuk e din.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit Gj. Gj. gjykata ia fali besimin dhe nga kjo dëshmia gjykata ka vërtetuar se R. M. vëllai i të akuzuarit I., kishte marr borxh prej një Malazezi e me që borxhin nuk ka mundur që ta kthejë ai edhe ishte kërcënuar me kidnapim, por H. kishte intervenuar duke i garantuar Malazezit se do ti kthehet borxhi, prandaj edhe R. është liruar. Natën kur ka ndodhur rasti kishin shkuar te shtëpia e R. Ismeti me tu përshëndetur me H. e ka tërhequr brenda në oborr, dëshmitari nuk është afruar por e kishte pa se I. pasi që H. dhe L. deri sa ishin duke u kthyer tek automjeti i tyre, e kishte parë I. që ka gjuajtr me armë në drejtimin e tyre, e në një moment e ka pa se është goditur L.

Dëshmitarja H. M. ka deklaruar se në momentin kritik ka parë H. dhe Ismetin të kapur për të njëjtën revole. Ajo nuk e din se e kujt ka qenë revolja. H. e kishte kapur për fyti I. dhe ka vërejtur se I. e kishte syrin e lënduar.

Dëshmitarja D. M. në momentin kritik ka vërejtur se djali i H. ka dashur ta largojë H. nga oborri. Dëshmitarja ka deklaruar se është e vërtetë se paradite me telefonin

24
e saj H. kishte biseduar me I. prej shtëpisë së tyre dhe janë marrë vesh që të bisedojnë në mbrëmje në ora 09:00.

Dëshmitarja L. M. ka theksuar se natën kritike ajo ka dalur nga oborri vetëm pasi kishte dëgjuar zhurmën dhe ka vërejtur se H. kishte kapur axhën I. për fyti, e në atë moment axha e kishte nxjerrë revolen dhe kishte bërtitur: "largohuni se do t'iu vras". Dy personat kanë dalë nga oborri të cilët kanë qenë H. e L., dhe kishte dëgjuar një krismë. Dëshmitarja ka treguar se krisma të tjera nuk kishte dëgjuar. Pas krismës ka vërejtur se H. ishte kthyer në oborr e tyre dhe një person tjetër ia ka dhënë thikën H. por ky nuk kishte qenë L.

Duke analizuar dëshmitë e dëshmitarëve H., D. dhe L. M. gjykata ia fali në tërësi besimin këtyre dëshmitëve nga të cilat u vërtetua se I akuzuari I. me të akuzuarin H. ishin marrë vesh që të takohen në ora 9:00 në mbrëmje që të bisedojnë. Natën kritike H. kishte kapur I. për fyti, e në atë moment I. kishte nxjerrë revolen dhe kishte bërtitur: "largohuni se do t'iu vras". H. e L. kishin dalë nga oborri kur ishte dëgjuar një krismë.

Dëshmitari T. S. ka dëshmuar se ka qenë prezent kur I. M. e Gj. Gj. në Lipjan në restorantin "Motrat Binjake" kanë biseduar me R. për punën e borxhit dhe kompensimin me arën e Sh. R. R. nuk e kishte kundërshtuar borxhin. Kur janë ndarë R. ka shkuar me ta, por nuk u ankua se dikush e ndalonte. Dëshmitari thekson se ata konsideruan se R. ka paguar borxhin me para kontratën që do ta bënte në realizimin e marrëveshjes që u bë me ta me atë rast.

Dëshmitari H. G. ka deklaruar se gjatë viti 2009 ka punuar në Mal të Zi në furrë tek H. M. Në një mbrëmje kishte shkuar një Malazez dhe i kishte thënë H. M. se ka me ia marr furrat, nuk e dinte arsyen, por H. ia kishte shpjeguar se fjala është që R. i kishte një borxh një Malazezi, ndërsa H. kishte garantuar për borxh për te. Në vazhdim ka deklaruar se edhe R. e ka njohur por nuk e dinte se çka ka punuar por të njëjtin e kishte parë në Mal të Zi, i njëjti kishte qëndruar 5 ditë në shtëpinë e H. M. dhe me të kanë ndejt bashkë bile edhe kanë ngrënë bukë.

Dëshmitari Sh. R. ka deklaruar se R. M. e kishte njohur 2-3 vite para këtij rasti e dinte që i njëjti ka punuar në një televizion privat e gjithashtu ka pasur edhe një firmë ndërtimtarie, pasi që dëshmitari kishte për nevojë për kryerjen e një pune në ndërtimtarie ishte marr vesh me R. që i njëjti ta kryente këtë punë për çka ia kishte dërguar punëtorët dhe materialin për kryerjen e fasadës në shtëpinë e tij. Pas kryerjes së punëve R. ia kishte dhënë llogarinë në vlerë prej 16.700 euro, mirëpo pasi që dëshmitari nuk kishte para në dorë R. i kishte thënë se mund t ia jep kur ti bën, i njëjti nuk kishte shkuar drejtpërdrejt që t ia kërkonte paratë por i kishte telefonuar duke iu ankuar se nuk ka para për çka e ka kuptuar se është duke ia kërkuar paratë. Me R. janë takuar në Prishtinë ku i kishte thënë se nuk ka para të gatshme por e ka një tokë e cila ndodhej në rrugën Prishtinë-Ferizaj të cilën dëshiron ta shes por se nuk ka myshteri, ndërsa R. kishte thënë se unë do ta gjej një myshteri i cili është i interesuar për ta blerë tokën, kështu që një ditë e kishte marrë një person i cili quhej L. M. me të cilin kishte shkuar e kishin këqyrë tokën. Në vazhdim ka deklaruar se nuk kishin biseduar për çmimin e tokës me R., mirëpo i njëjti i kishte thënë se sipas vendit ku është ajo tokë mundet me kushtua diku 500 euro për ari, për çka dëshmitari është pajtuar ndërsa në bisedë e sipër R. e kishte treguar se këtij myshteriu të cilin e ka gjetur për ta blerë tokën i kishte para borxh, ka shtuar se një ditë ai, R. dhe personi me emrin L. M. ishin takuar në një kafeteri në Lipjan ku janë marr vesh që dëshmitari t ia nënshkruan kontratën drejtpërdrejt L. M.

161
për sipërfaqen e tokës prej 40 ari e pasi që ia kishte R. borxh 16.700 euro, 3.300 euro R. ka qenë dashtë t'ia kthej dëshmitarit. Nuk kishin lidh kontratë të drejtpërdrejt me R., pasi që Rafeti ka kërkuar ashtu sepse i kishte borxh L. dhe drejtpërdrejt dëshironte që ta kompensonte me tokën që merrte nga unë; kështu që që të tre kanë shkuar te një avokat në Lipjan, kanë përpiluar një kontratë të shitblerjes por të njëjtën nuk e kanë vërtetuar në gjykatë, pasi që këtë tokë dëshmitari ia jepte R. si kompensim për borxhin prej 16.700 euro me kusht që diferencën R. t'ia paguante por kjo parcelë nuk ishte e ndarë, prandaj edhe kanë lidhur kontratën pa u vërtetuar në gjykatë me qëllim që këtë sipërfaqe prej 40 ari pas kryerjes së procedurës së trashëgimisë ta qes mbi veti, e pastaj kontratën ta vërtetojë në gjykatë.

Nga dëshmitë e dëshmitarëve T., S., H., G. dhe Sh. R. gjykata ka vërtetuar se i akuzuari H. M. kishte pasur një problem me një Malazez dhe atë për shkak se i njëjti kishte garantuar për një borxh të cilin R. M. (vëllau i të akuzuarit L. M. ia kishte këtij Malazezi. Nga ana tjetër R. M. kishte kryer një punë ndërtimore për dëshmitarin Sh. R. i cili si kompensim për punën e bërë i kishte ofruar një pjesë të paluajtshmërisë që i njëjti e posedonte në Lipjan. Në këto rrethana R. M. këtë paluajtshmëri kishte ofruar L. M. si kompensim për borxhin që R. M. ia kishte të akuzuarit H. M., për çka edhe lidhin një kontratë lidhur me këtë borxh.

Nga procesverbali mbi rikonstruimin e vendit të ngjarjes i datës 10.01.2012 vërtetohet se trupi gjykues kanë bërë rikonstruimin e vendit të ngjarjes ku i akuzuari I. M. ka shpjeguar se ngjarja ka filluar te dera e oborrit të tij në brendësi të oborrit, veprime që i ka ndërmar H. dhe L. në oborr e pastaj edhe në rrugë, gjithashtu edhe H. M. ka shpjeguar ecurinë e ngjarjes ku ka shpjeguar se zhvillimi i ngjarjes ditën kritike ka filluar në momentin kur ai i ka raziles së derës së oborrit të I. M. dhe pas pak kishte dal i akuzuari e ka tërheq dhe ka shti me dhunë në brendi të oborrit të tij, veprimet e ndërmarra në oborr i ka përshkruar si rrëmujë e madhe ku ka deklaruar se është munduar me u mbrojt edhe me thikë dhe e tërë ngjarja prej oborrit ka kaluar në rrugë dhe ka vazhduar deri te plagosja me armë zjarri nga ana e të akuzuarit birin e tij tani të ndjerin I. M.

Nga ekspertiza e ekspertit të mjekësisë ligjrore Dr. C. M., elaborimi gojor i Dr. C. M. për lëndimet e të dëmtuarit L. M. në shqyrtimin kryesor është vërtetuar se i dëmtuari L. M. ka marrë lëndime të përshkruar në të tretës së sipërme të faqes së brendshme të kofshës së djathtë që klasifikohen në plagë shkuese e shkaktuar nga dinamika e veprimit të predhës së ndezur nga arma e zjarrit e që si e tillë dhe e vetme ka përshkruar lëkurën, indet e buta duke përfunduar në brendi të kofshës, lëndim i përshkruar në maje të organit gjinor mashkullor që klasifikohet me gërvishtje i shkaktuar nga dinamika e veprimit të pjesës mbretëse të mjetit të fortë, furishëm sulmues mekanik, të gjitha këto lëndime klasifikohen në lëndime të lehta trupore pa elemente të rrezikshmërisë për jetën në çastin e shkaktueshmërisë.

Nga raporti i rikonstruimit të vendit të ngjarjes të kryer nga Njësia e Forenzikës Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren me nr. RVK- 20 i datës 10.01.2012, skica e vendit të ngjarjes dhe foto albumi është vërtetuar se vendi i ngjarjes përfshin një rrugë përpjetëze në kupëza betoni ku në të dy anët janë muret dhe shtëpitë e lagjes konkretisht përfshin rrugën para derës së shtëpisë me nr.21 a dhe 23 duke vazhduar në oborrin e shtëpisë në të njëjtin numër dhe përfundon në bodrumin e shtëpisë e cila në fakt është edhe shtëpia e të dyshuarit I. M. Në fillim të rikonstruimit të vendit të ngjarjes janë vendosur të gjitha pikat e dëshmimeve të cilat janë gjetur ditën kritike, janë bërë matjet e ndryshme si dhe janë marr deklarata nga të akuzuarit dhe të dëmtuarit lidhur me veprimet e tyre ditën kritike, pas përfundimit të këtyre matje ka përfunduar rikonstruimi i vendit të ngjarjes.

16.

Gjendjen e këtyllë faktike gjykata e ka vërtetuar nga deklaratat e ekspertit të balistikës profesor H. K. , i cili edhe në raportin e tij të datës 10.01.2012, pas pjesëmarrjes në rekonstruimin e pjesërishëm të vendit të ngjarjes si dhe gjatë shqyrtimit kryesorë ka deklaruar se ngjarja kritike është zhvilluar në dy etapa, dhe atë në oborrin e të akuzuarit I. M. ka qenë përplasja apo kacafytja e parë ku kanë mbetur gjurmët, brenda derës hyrëse është gjetur një gëzhjojë pastaj kemi njollën e gjakut e cila është gjetur para gomës së djathtë të automjetit "kombi Mercedes" i parkuar në oborr, afër gomës së prapme të djathtë është gjetur pistoleta automatike me tre fishek në karikator dhe një në tytë e shënua me nr.10, afër murit të betonit në vazhdim ana e djathtë e automjetit është gjetur thika e gjuetisë e shënua me nr.9, ndërsa në podrumin e shtëpisë i cili është në anën e djathtë prej derës hyrëse është gjetur një karikator me 20 fishek që i takon pistoletës automatike "Shkorpion".

Pjesa e dytë e ngjarjes, është zhvilluar në rrugë dhe atë para dyerve të shtëpisë me nr.21 a dhe asaj të akuzuarit 23, dhe derës në anën e kundërt me nr.32, në këtë pjesë të rrugës kishte gjurma duke filluar prej mesit të rrugës pak më larg se dera e të akuzuarit një njollë gjaku të shënua me D1, pak më sipër një gëzhjojë, pastaj duke vazhduar rrugën në trotuar para shtëpisë me nr.32 janë gjetur dy gëzhjoja, ndërsa në rrugë një gëzhjojë dhe një papuç. Eksperti ka konstatuar se është për tu diskutuar gëzhjoja e gjetur në oborrin e shtëpisë së të akuzuarit e shënua me nr.7 në pjesën në mes dy krahëve të dyerve. Pistoleta automatike SHKORPION kal.9 x 19 mm, pas të shtënave gëzhjoja i hedh në anën e djathtë dhe te rasti konkret lejohet mundësia që i akuzuari ka shti me pistoletë kur ka qenë para dera, dera e hapur dhe gëzhjoja është hedh në brendi në oborr. Janë përcaktuar edhe distancat e gëzhjojave në rrugë në krahasim me automjetin e parkuar afër së cilit është plagosur L. M. sipas dëshmitarit H. M. , prej mesit të derës së oborrit të shtëpisë së I. M. e deri te automjeti i parkuar sipas dëshmitarit (voztësit të automjetit) Gj. Gj. janë 20.70 m.

Pistoleta automatike e markës "Shkorpion" prodhim Gjerman e kalibrit 9 x 9 mm e gjatë, kjo pistoletë e ka pasur karikatorin me 10 fishek, 5 fishek kanë qenë të zbrazur, një ka qenë në tytë, ndërsa 3 fishekë janë gjetur në karikator, një fishek ka munguar. Të shtënat kanë qenë automatike, e që kjo armë është në gjendje që të zbrazë 500 deri në 600 fishek në minutë, mirëpo nëse gjuhet me vëmendje atëherë brenda minutë mund të zbrazen 150 deri 200 fishek e që rafalët mund të jenë të shkurta dhe të gjata. Lidhur me gëzhjojën nr.7 eksperti ka deklaruar se kjo gëzhjojë është zbrazur në etapën e dytë të zhvillimit të ngjarjes kur personi ka qenë në derë të oborrit me tytë dhe pistoletë të drejtuar jashtë, pas shtënies gëzhjoja është hedhur në të djathtë por ka hy brenda ka mund të jetë dera e hapur e cila e ka ndru kahjen dhe gëzhjoja ka hy brenda oborrit. Pistoleta "Shkorpion" gëzhjoja i hedh në anën e djathtë në një kënd prej 110 shkallës dhe në një distancë 2-2.5 metra varësisht prej pozitës se si mbahet dora. Në rastin konkret pasi që terreni është i pjerrët rruga e shtruar me kupëza të betonit eksperti është nisur nga fakti se gëzhjoja janë rrokullisur dhe janë larguar prej gëzhjës nr.2 e cila i përgjigjet afërsisë së vendit ku ka qenë personi që ka shtënë me armë zjarri dhe njollës së gjakut, gëzhjoja tjera janë shumë larg prej derës, kështu që personi është ofruar. Te rasti konkret sikurse edhe te rastet tjera distanca e të shtënave me armë zjarri caktohet në bazë të pozitës ku kanë mbetur gëzhjoja, gjurmët e gjakut, dëmtimet nga projektili, këto janë bazë që bashkangjiten edhe provave tjera, e te rasti konkret gjurma e gjakut e shënua me D 1 e cila është më së largti nga dera nga ka shtënë i akuzuari dhe njolla e gjakut janë parametra nga të cilat është përcaktuar pozita ku ka qenë personi që ka shtënë me armë, ndërsa distanca në mes të automjetit të dëmtuarit dhe gjurmës së gjakut është 9.20 metra.

Sipas ekspertit pasi janë krahasuar gjurmët në vendin e ngjarjes gjatë shikimit dhe rekonstruksionit me shpjegimet e dëgjuar nga i akuzuari dhe dëshmitari mund të konstatohet se : plagën në pjesën e këmbës së djathtë mbi gju e ka marr L. M. gjatë zhvillimit të ngjarjes në etapën e dytë në rrugë ku janë gjetur 4 gëzhoja të zbrazura nga pistoleta automatike SHKORPION cal. 9 x 19 mm me nr.serik: 42504. Pozicioni ku janë gjetur gëzhojat në pjesën e rrugës dhe atë dy në rrugë dhe dy në trotuar ju përgjigjen karakteristikave të pistoletës Shkorpion e cila i hedh gëzhojat në anën e djathtë me një distancë deri në dy metra, rrokullisjes së tyre në kupëzat e betonit me të cilat është rruga e shtruar, dhe përpjetës së vogël së rrugës.

Nga të gjitha provat e administruara si dhe nga dëgjimi i dëshmitarëve në rastin konkret rezulton se nuk është kontestuese fakti se i akuzuari H. M. me të dëmtuarin L. natën kritike kishin shkuar në shtëpinë e të akuzuarit I. M. për të biseduar rreth borxhit të vëllait të tij, me ta kishte shkuar edhe dëshmitari Gj. Gj. Me të arritur tek dera e oborrit të shtëpisë së të akuzuarit I. M. i njëjti me të hapur derën fillon një konflikt verbal në mes tyre e pastaj edhe një konflikt fizik në mes të akuzuarit I. M. dhe H. M., për çka intervenojnë familjarët e të akuzuarit I. M. e gjithashtu i njëjti edhe i kërcënon me armë, për çka i akuzuari H. M. dhe i dëmtuari L. largohen nga oborri i tij dhe nisen në drejtim të automjetit të tyre, kurse i akuzuari I. M. ju vihet pas dhe nga dera e oborrit shtënë me revole në drejtim të tyre me ç'rast e qëllon të dëmtuarin L. M. Pra gjykata ka vërtetuar se në momentin kur i akuzuari I. M. ka shtënë në drejtim të tyre fare nuk ka qenë i sulmuar nga askush, pra nuk bëhet fjalë për kurrfarë sulmi ndaj tij. Nuk është kontestuese se përleshja në mes të akuzuarit I. M. dhe të akuzuarit H. M. kishte ndodhur brenda oborrit të shtëpisë së të akuzuarit I. M., por e gjitha kishte përfunduar në momentin kur intervenojnë familjarët e tij dhe pas kërcënimit me armë i akuzuari H. M. dhe i dëmtuari L. M. i cili fare nuk ishte i involvuar në atë përleshje largohen nga shtëpia dhe nisen në drejtim të veturës së tyre. Një fakt të tillë e vërteton edhe ekspertiza ballistike i cili ka konstatuar se plagët L. M. i ka marr gjatë zhvillimit të ngjarjes në etapën e dytë në rrugë ku janë gjetur 4 gëzhoja të zbrazura nga pistoleta automatike SHKORPION.

Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për mbrojtjen e nevojshme nga se sipas dispozitës së nenit 8 të KPK që të ketë mbrojtje të nevojshme duhet të ekzistojë sulmi i cili sulm duhet të jetë i atëçastshëm, i kundërligjshëm, real dhe i drejtuar kundër jetës së të akuzuarit e që në rastin konkret nuk ka ekzistuar një sulm i tillë.

Është vet i akuzuari I. M. i cili në mbrojtjen e tij deklaron se pasi që i është kërcënuar me armë i akuzuari H. M. dhe i dëmtuari L. M. largohen nga oborri i tij e që më pastaj i njëjti ju vihet pas dhe gjuan në drejtim të tyre, edhe pse mbrohet se gjoja ata kthehen dhe e kanë sulmuar një gjë e cila nuk është vërtetuar. Faktin se i akuzuari H. M. dhe i dëmtuari L. M. janë larguar nga oborri i të akuzuarit I. M. pasi që i njëjti i kërcënon, e vërtetojnë edhe familjarët e të dëmtuarit I. M. të cilët kanë deklaruar se ata janë larguar nga oborri kur I. M. kishte drejtuar revolen në drejtim të tyre dhe se kishin dëgjuar një krismë kur i akuzuari prej dyerve të tij kishte gjuajtur në drejtim të tyre, pra është vërtetuar se në momentin kur i akuzuari I. M. ka gjuajtur në drejtim të tyre nuk ka qenë fare i sulmuar nga askush aq më tepër kur është vërtetuar se i dëmtuari L. M. në drejtimin e të cilit gjuan dhe e godet i akuzuari I. M. për asnjë moment nuk e ka sulmuar të akuzuarin I. M., pra në rastin konkret gjatë gjithë kohës sa është zhvilluar ngjarja i dëmtuari L. M. nuk e ka sulmuar të akuzuarin I. M., e që nuk ka ekzistuar kurrfarë sulmi ndaj tij, pra nuk mund të flitet fare për mbrojtje të nevojshme, në këto rrethana as edhe për tejkalim të mbrojtjes së nevojshme.

WB

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha këtyre provave duke analizuar secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku gjeti se në veprimet e të akuzuarit I M formohen të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK, Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat gjykata këtu të akuzuarin e shpalli fajtor dhe të njëjtit i shqiptojë dënimin, më afër të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konform nenit 73 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është kryer vepra, prej rrethanave lehtësuese gjykata morri parasysh qëndrimin korrekt të tij, se është person familjarë babai i dy fëmijëve. Dënimi i shqiptuar të akuzuarit sipas gjetjes së gjykatës është në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprës së kryer penale dhe se kur të merret parasysh shkalla e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, dënimet e këtilla paraqiten si të domosdoshme me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit, me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Sa i përket të akuzuarit H. M gjykata në pajtim me nenin 363 par. 1 pika 1.1 të KPP ka marrë aktgjykim refuzues për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza ndaj të njëjtit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 KPP.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike është marrë në bazë të nenit 463 par.2 të KPP të Kosovës.

Nga se u tha më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.313/2012 me datë 22.05.2017

Procesmbajtësja
Birsën Kume

Kryetari i trupit gjykues,
Skender Çoçaj

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit – Gjykatës së Apelit të Kosovës – DKR në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.